

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 87, DATË 14.2.2018 PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË GAZIT NATYROR NË SHQIPËRI DHE IDENTIFIKIMIN E PROJEKTEVE PRIORITARE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Dokumenti i Masterplanit të Gazit për Shqipërinë i miratuar me Vendimin nr. 87, datë 14.2.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”, shqyrton të gjitha aspektet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të furnizimit me gaz natyror duke përfshirë dhe çështjet teknike, ligjore, rregullatore, ekonomike, tregtare, mjedisore, dhe sociale që lidhen me futjen e gazit në Shqipëri. Masterplani i Gazit (MPG) ka për qëllim të mbështesë zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të gazit natyror që mundëson një kontribut të ekuilibruar dhe eficient të këtij produkti energjetik në sektorin dhe tregun e energjisë, nëpërmjet sigurimit të furnizimit me gaz përmes konkurrencës dhe mbrojtjes së mjedisit. MPG ka shqyrtuar kërkesën dhe ofertën për gazifikimin e mundshëm të të gjitha qyteteve të mëdha dhe konsumatorëve të mëdhenj industrialë në periudhën 2020 deri 2040, duke përfshirë impiantet e prodhimit të energjisë elektrike (TEC-et), që do të përdorin gazin natyror si lëndë djegëse.

Shoqëria shtetërore e gazit në Shqipëri, Albgaz sh.a. e mbështetur në dokumentin e MPG të miratuar me Vendimin nr. 87, datë 14.02.2018, si dhe në studimet e të cilave janë realizuar në kuadër të Fondit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF), ka identifikuar dhe vijuar ndjekjen e disa projekteve strategjike prioritare, me qëllim zhvillimin e sektorit të gazit natyror në vendin tonë. Në kuadër të zhvillimeve të fundit të sektorit të gazit natyror, si dhe shprehjes së interesit të shoqërive të huaja për bashkëpunim me qeverinë shqiptare në këtë fushë, si dhe duke vlerësuar dhe trajtuar më në detaje nga ana tekniko financiare projektet prioritare të nxjerra nga dokumenti i MPG, ka propozuar disa ndryshime të MPG, të cilat mundësojnë përshtatjen dhe arritjen e parametrave teknikë të këtyre projekteve prioritare me hapat që do të ketë zhvillimi i sektorit të gazit.

Qëllimi i veçantë i përgatitjes së këtyre ndryshimeve të “Planit të Zhvillimit të Sektorit të Gazit Natyror në Shqipëri (Master Planit të Gazit Natyror për Shqipërinë) është të sigurojnë zhvillimin efikas dhe të qëndrueshëm të një sektori që do të jetë pjesë integrale dhe shumë e rëndësishme e sektorit strategjik energjetik, duke mbështetur objektivat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe social të Shqipërisë si dhe integrimin e ardhshëm të vendit në Bashkimin Evropian, në përputhje të plotë me vizionin strategjik të Qeverisë dhe konceptet kryesore të Politikës Energjetike Evropiane.

Në funksion të përmbushjes së kësaj detyre nga ana e strukturave përgjegjëse të MIE dhe shoqërisë Albgaz sh.a. u punua për përgatitjen e ndryshimeve të VKM nr.87, datë 14.02.2018.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 87, datë 14.2.2018 për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”.

ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është planifikuar në programin analitik të projektakteve për vitin 2023 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në studimet/raportet që përbëjnë Master-Planin e Gazit për Shqipërinë është supozuar që sistemi i transmetimit të gazit në Shqipëri do të furnizohet me gaz natyror nga gazsjellësi "TAP", i cili do të përbëjë edhe objektin më të rëndësishëm strategjik në zhvillimin e sektorit të gazit në Shqipëri dhe lidhjen e Shqipërisë me rrjetet rajonale dhe evropiane të gazit. Gjithsesi, në këtë dokument janë marrë në konsideratë dhe janë trajtuar edhe mundësitë e furnizimit të sektorit të gazit në Shqipëri nga burime vendase të sektorit të gazit, që janë zbuluar apo priten të zbulohen në kuadër të aktivitetit të kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve në Shqipëri, apo edhe burime të tjera furnizimi.

Projektet prioritare të identifikuar në Master Planin e Gazit për Shqipërinë dhe që propozohet për t'u financuar në të ardhmen, janë ndarë në Terma Afatshkurtër, Terma Afatmesëm dhe Terma Afatgjatë, të grupuara si më poshtë:

- Në terma afatshkurtër

1. Zhvillimi i gazsjellësit TAP – TEC-i i Vlorës, dhe nëse është e mundur, zhvillimi i sistemit të shpërndarjes së gazit në qytetin e Vlorës;
2. Zhvillimi i sistemit të transmetimit për të furnizuar konsumatorët kryesorë në Fier dhe Ballsh dhe nëse është e mundur zhvillimi i sistemeve lokale të shpërndarjes së gazit në zonat e Fierit dhe Ballshit;

- Në terma afatmesëm

3. Zhvillimi i sistemit të transmetimit për të furnizuar kryesisht zonat industriale në Elbasan, si dhe zhvillimi i hapësirave të depozitimit nëntokësor të gazit në Dumre;
4. Zhvillimi i sistemit të transmetimit për furnizimin e konsumatorëve industrialë dhe komercialë në zonën e Durrësit dhe të Tiranës;

- Në terma afatgjatë

5. Zhvillimi i gazsjellësit ndërlidhës me Kosovën
6. Zhvillimi i sistemit të transmetimit të gazit afër Korçës, për të furnizuar TEC-in e planifikuar të Korçës, sistemin e shpërndarjes së gazit në Korçë, dhe më tej në Pogradec;
7. Zhvillimi i sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes në Shkodër;
8. Zhvillimi i sistemit të transmetimit nga Ballshi në Tepelenë dhe në Gjirokastrë, si dhe sistemet lokale të shpërndarjes së gazit;
9. Zhvillimi i sistemit të transmetimit nga Pogradeci në Prenjas dhe më tej në IRJ të Maqedonisë;
10. Zhvillimi i sistemit të transmetimit për TEC-in e planifikuar në Kuçovë dhe sistemin e shpërndarjes në Kuçovë;

Lidhur me këto projekte prioritare janë verejtur e zhvillimet e fundit të sektorit, sikurse janë:

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 87, datë 14.2.2018 për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare".

- **Ndërtimi i linjës së transmetimit të tubacionit të gazit natyror Fier-Vlorë**

Lidhur me projektin e detajuar të linjës së transmetimit të gazit natyror Fier-Vlorë, i cili është vlerësuar si prioritar në përputhje me parashikimet e VKM nr. 87/2018 (Master Planit të Gazit Natyror për Shqipërinë), shoqëria Albgaz sh.a. po merr masat e nevojshme mbi planifikimet tekniko-financiare, sikurse edhe vlerësimin e kuadrit rregullator, në zbatim të legjislacionit në fuqi, për mundësinë e ndërtimit të tubacionit Fier – Vlorë.

Ndërtimi dhe realizimi i këtij projekti prioritar konsiderohet i rëndësishëm ndër të tjera edhe për disa aspekte si vijon:

- a. *Krijon mundësinë e infrastrukturës ndërlydhëse kritike ndërmjet gazsjellësit TAP dhe TEC Vlorë (në bazë të një shprehjeje interesi nga KESH) për të garantuar sigurinë e furnizimit dhe për pasojë plotësimin e një mase sa i përket sigurisë energjetike të vendit.*
- b. *Krijon mundësinë e gazifikimit të qytetit të Vlorës, i cili po përjeton moment mjaft të rëndësishëm sa i përket zhvillimit të infrastrukturës aeroportuale dhe asaj portuale, zhvillimi industrial dhe atij turistik;*
- c. *Krijon mundësinë e gazifikimit të qytetit të Fierit, kryesisht në drejtim të furnizimit industrisë me një burim alternativ energjie, referuar edhe historikut të qytetit;*

Përpos sa vlerësuar edhe në dokumentin teknik të VKM nr. 87/2018, tubacioni Fier-Vlorë krijon potencialin për injektimin e gazit në tubacionin TAP. Mundësia e rrjedhjes së kundërt të gazit “jug-veri” lind si potencial i disa projekteve të mundshme, të cilat në kushtet aktuale të zhvillimeve të sektorit energjetik në Evropë dhe atij të gazit natyror në veçanti, janë evidentuar se të tilla në kuadër të propozimeve apo vlerësimeve të realizuara nga Marrëveshje Bashkëpunimi (MoU) datë 12.03.2021 të lidhura nga Qeveria Shqiptare me partneritet strategjik, MIE-Excelerate Energy-ExxonMobil si dhe “Cooperation Agreement” (jo detyruese) ndërmjet Albgaz dhe Enagas datë 04.10.2022, sikurse Memorandumi i Bashkëpunimit mes Albgaz dhe Overgas me datë 14.04.2022, me objekt eksplorimin e mënyrave të bashkëpunimit të mundshëm në sektorin e gazit natyror, duke përfshirë por pa kufizuar vetëm në ndërtimin e infrastrukturës.

Në të gjitha këto memorandume, para se gjithash, bihet dakord për kryerjen e studimeve të nevojshme për zhvillimin e mundshëm të terminalit të gazit të lëngshëm (LNG) në Portin e Vlorës. Për më tepër nën MoU, parashikohet që të eksplorohej potenciali i një zgjidhjeje të integruar LNG e cila përfshin shndërrimin dhe zgjerimin e termocentralit ekzistues në Vlorë, si dhe krijimin e objekteve infrastrukturore për shpërndarjen e LNG në shkallë të vogël në Shqipëri dhe rreth rajonit të Ballkanit.

Në kushtet e tregjeve dhe infrastrukturave energjetike që pas vitit 2022, qasja për injektimin në rrjetet e transmetimit të gazit natyror (GN) nga terminale të gazit të lëngëzuar GNL/GN, në të gjithë Europën, jo vetëm që paraqiti fizibilitet në aspektin ekonomik, por edhe bëri të mundur garantimin e sigurisë së furnizimit me gaz natyror. GNL-synon të sjellë energji nga burime të tjera alternative, të përballeshme dhe më të pastra me qëllim garantimin e mbulimit të nevojës për GN brenda vendit por edhe tregtim jashtë saj.

Statusi aktual i Projektit të terminalit, është në fazën e modelimit tekniko-ekonomik në bashkëpunim me palë të interesuara dhe aktorë/partnerë si: ExxonMobil, Excelerate Energy, Enagas, SNAM, Socar, TAP.

Konkretisht propozimet dhe diskutimet e Terminalit të gazit të lëngëzuar (GNL) në Vlorë, kanë evidentuar përpos ofrimit të sigurisë në furnizim edhe potenciale aktiviteti ekonomik, përmbledhur si më poshtë:

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 87, datë 14.2.2018 për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”.

- Plotësimi i infrastrukturës së GN në Shqipëri edhe me një impiant të gazit të lëngshëm, i cili vlerësohet se do të krijojë mundësi për garantimin e sigurisë së furnizimit me GN të klientëve, përfshirë edhe klientin spirancë, TEC-in e Vlorës dhe potencialisht shtimin e kapacitetit të tij në të ardhmen.
- Injektimin e gazit nga Terminali i Vlorës në tubacionin TAP, duke pasur kështu aksesin në tregjet rajonale dhe më gjerë, atyre evropianë.
- Mundësimi i diversifikimit të aktivitetit tregtar, për të cilat infrastruktura (Fier-Vlorë) mund të vihet në përdorim.
- Ngritjen dhe zhvillimin e një infrastrukture të shpërndarjes GNL në shkallë të vogël (small-scale distribution) për të mbuluar kërkesat rajonale për gaz në sektorët industrialë, komercialë dhe të transportit.
- Ofrimi i mundësisë së përdorimit të infrastrukturës për transmetimin e rezervave vendase.

Ne lidhje me mundësinë e transmetimit të hidrogjenit, Bashkimi Evropian aktualisht është duke ndërmarrë nisma konkrete ligjore (COM/2021/803 final) duke vlerësuar një ndryshim në Direktivën e vitit 2009, për gazin natyror, direktivën me të cilën është përafëruar plotësisht edhe legjislacioni kombëtar për sektorin e Gazit Natyror (Ligji 102/2015), me fokus integrimin në vecanti sa i përket infrastrukturave, të mundësive të transmetimit të Hidrogjenit. Aktualisht, në dokumentin e zotëruar të projektit Fier-Vlorë, nuk ka asnjë parashikim lidhur me potencialin teknik të infrastrukturës për lejimin dhe të injektimit të hidrogjenit apo përzierjeve GN-Hidrogjen, i cili potencialisht mund të përfshihet në TAP.

Gazsjellesi TAP është në fazën e zgjerimit me faza, në mënyrë që të mundësohet injektimi i gazit drejt TAP, kërkohej nga ky i fundit, që në pikën hyrëse/dalëse në Fier Jug, një presion hyrjeje deri në 95 bar., kjo referuar edhe marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur me TAP, në zbatim të detyrimeve të TAP sipas Marrëveshjes së angazhimit për zhvillimin e tregut të gazit, kjo bazuar në VKM nr. 233, datë 21.03.2017 “Për miratimin e marrëveshjes së angazhimit për zhvillimin e tregut të gazit dhe marrëveshjes për përfitimet vendase, të lidhura ndërmjet Republikës së Shqipërisë, e cila vepron nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellesit Trans Adriatik”.

Një aset infrastrukturor i lidhur ngushtë me tubacionin është edhe *Pika e Daljes në Fier*, rregulluar nëpërmjet “Marrëveshje Bashkëpunimi dhe dorëzimi për objektin e Seksionit Jugor në Fier”, mes palëve MIE dhe TAP AG (COHA). Sipas Marrëveshjes HGA, TAP do të ndërtojë dhe më pas dorëzojë nëpërmjet “Handover Agreement” Pikën e Daljes, e projektuar për një volum prej 0.7-1.8 bcm.

Stacioni PRMS është parashikuar që të operojë në dy drejtime (bidirectional), çka do të thotë se ky stacion jo vetëm që do të sigurojë furnizimin me gaz të rajonit jugor të Shqipërisë, por i jep mundësinë të gjithë operatorëve të cilët duan të aksesojnë korridoret ndërkombëtare të gazit natyror nëpërmjet kësaj porte hyrëse në tubacionin e TAP.

Pika 3.5 parashikon ekspansionin dhe mundësinë e rrjedhjes me dy drejtime, të cilat janë përmbajtur në objektivat e kësaj Marrëveshje. Dispozita për rrjedhjen në dy drejtime kërkon instalimin e valvulave manuale dhe stacionit të bypass-it të pershtatur për rrjedhjen bi-direksionale.

Kontastohet se, Projekti i detajuar i tubacionit Fier Vlorë, nuk ka parashikuar bi-direksionalitetin dhe parashikohet me presion projektimi deri në 50 bar kjo sipas GMP.

Duke konsideruar këto zhvillime në përputhje me planet dhe politikat energjetike e hidrokarbure të MIE-s në vend, lind nevoja e përshtatjes teknike të projektit aktual të WBIF për të krijuar parametrat e nevojshëm, të cilat do të mundësojnë projekteve ose entiteve të ndryshëm për të injektuar gaz natyror

në tubacionin TAP, sikurse dhe rishikimi i projektit për përfshirjen edhe të kapaciteteve të nevojshme teknike që mundësojnë përdorim të infrastrukturës edhe për Hidrogjen.

• Gazifikimi i qytetit të Korçës

Projekti i ndërtimit të infrastrukturës së shpërndarjes gazit natyror në Korçë, parashikohet për tu zhvilluar edhe në MasterPlanin e Gazit, VKM 87/2018. Ky rrjet parashikohet të lidhet me tubacionin TAP në afërsi të qytetit të Korçës dhe vijon me ndërtimin e rrjetit të shpërndarjes në këtë qytet, gjithashtu parashikohet lidhja me anë të linjës së transmetimit me qytetin e Pogradecit e duke vijuar më tej me qytetin e Prrenjastit.

Projekti i gazifikimit të qytetit të Korçës, në Master Planin e Gazit, është konsideruar si një projekt prioritar me terma afatgjatë. Megjithatë, bazuar në potencialin e mundshëm të konsumit, ndërtimin e infrastrukturës së shpërndarjes por edhe interesit të shprehur, përbën një nga projektet i cili kërkon aktualizimin dhe riklasifikimin si një projekt prioritar bazuar në premisat dhe qasjen e ndërtimit të rrjetit të shpërndarjes në qytet dhe në rrethinat e Bashkisë Korçë.

Përsa më sipër, është evidentuar interes i shtuar nga shtete partnere strategjike të Republikës së Shqipërisë, për realizimin e projektit për gazifikimin e qytetit të Korçës. Konkretisht, interesa janë shprehur nga përfaqësues të qeverisë së Azerbajxhanit, në kuadër të intensifikimit të bashkëpunimit dhe realizimin e projekteve mes shteteve.

Gjithashtu, shoqëria Albgaz, po realizon, në kuadër të interesit të shprehur, një vlerësim dhe studim në lidhje me realizimin e projektit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes në qytetin e Korçës, nëpërmjet së cilit vlerësohet se potencialisht ky projekt duhet të riklasifikohet si një projekt me prioritet afatshkurtër, duke e reflektuar këtë në Masterplanin e gazit natyror.

• Shpërndarja në shkallë të vogël të gazit natyror të lëngshëm

Gazi natyror i lëngshëm mund të gjejë shumë përdorime në vendin tonë dhe të kontribuojë në strategjinë e diversifikimit të furnizimit me energji, duke sjellë përfitime të shumta direkte për përdoruesit fundor përsa i përket kostos dhe efikasitetit, me një theks të vecantë tek qëndrueshmëria e një burimi të tillë energjie dhe domosdoshmëria e tij për vendin tonë, i cili mbështetet tërësisht në energjitë e rinovueshme, duke krijuar varësi ekstreme nga importi, veçanërisht gjatë sezonit të verës.

Aplikimi i suksesshëm i LNG në shkallë të vogël do të nënkuptojë vendosjen e një pjese kritike të munguar në mozaikun energjetik, duke krijuar përfitime të mëdha për të gjithë aktorët:

- Për përdoruesit fundor ulje të kostos;
- Për kompanitë vendase dhe të huaja mundësi biznesi;
- Për interesin kombëtar diversifikim të burimeve dhe si rrjedhojë rritjen e pavarësisë energjetike.

Aktualisht, në parashikimet e Raportit Përfundimtar të Master Planit të Infrastrukturës së Gazit, pjesë e VKM nr. 87/2018, parashikohen si prezumime, disa norma teknike të presionit të rrjeteve, këto të marra në konsideratë për qëllime studimi të Masterplanit sipas skenarëve. Konkretisht standarti i prezumuar i presionit në rrjetet e propozuara dhe studiuara është:

Parametrat e përgjithshme të sistemit të transmetimit në Shqipëri janë:

1. Presioni Maksimal i Lejuar:

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 87, datë 14.2.2018 për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare".

- 82 bar, për seksionet e IAP dhe 50 bar për pjesën tjetër të sistemit të transmetimit në Shqipëri
- 50 bar për sistemin e transmetimit në Shqipëri kur IAP nuk ekziston.

Ky prezumim vjen si rrjedhojë e hipotezës kryesore të Raportit dhe studimi i cili është “Supozohet se gazifikimi i Shqipërisë fillon me fillimin e funksionimit të gazsjellësit TAP-it si infrastruktura kryesore gazifikuese.¹

Gjithashtu, prezumimi i rëndësishëm i konsideruar në raport, qëndron edhe në faktin se burimet e gazit natyror në vend janë të kufizuara².

Bazuar në parashikimet e Vendimit nr. 233, datë 21.03.2017 “Për miratimin e marrëveshjes së angazhimit për zhvillimin e tregut të gazit dhe marrëveshjes për përfitimet vendase, të lidhura ndërmjet Republikës së Shqipërisë, e cila vepron nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik” dhe “Marrëveshje Bashkëpunimit dhe dorëzimi për objektin e Seksionit Jugor në Fier” mes palëve MIE dhe TAP AG (COHA), nënshkruar sipas Marrëveshjes HGA, TAP do të ndërtojë dhe më pas dorëzojë nëpërmjet “Handover Agreement” Pikën e Daljes, e projektuar për një volum prej 0.7-1.8 bcm, Stacioni PRMS i cili do të operojë në dy drejtime (bidirectional).

Ky parashikim do të thotë se ky stacion jo vetëm që do të sigurojë furnizimin me gaz të rajonit jugor të shqipërisë, por i jep mundësinë të gjithë operatorëve të cilët duan të aksesojnë korridoret ndërkombëtare të gazit natyror, nëpërmjet kësaj porte hyrëse në tubacionin e TAP. Gjithashtu dy drejtime, bidireksionaliteti është parashikuar edhe në vetë Raportin e masterplanit të gazit, por në gjuhën angleze jo në gjuhën shqipe pjesë e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 87/2018.

Si rrjedhojë e kontekstit të trajtuar më sipër, lidhur me interesat indikative në qarkullimin e gazit të lëngshëm natyror (GNL), efekteve në tregjet dhe infrastrukturën e gazit pas vitit 2022, interesit të shtuar për rjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, potencialit të mundshëm të gazit natyror i cili mund të rezultojë në kërkimet aktuale brenda territorit të vendit tonë, është i nevojshëm që në bazë të standardeve të referuara kombëtare për gazin natyror, të përditësohen disa prezumime të realizuara në raportin përfundimtar të VKM nr. 87, datë 14.2.2018 “Për miratimin e Planit të Zhvillimit të Sektorit të gazit natyror në Shqipëri (Master Planit të Gazit Natyror për Shqipërinë) dhe Identifikimin e Projekteve Prioritare në Fushën e Gazit Natyror”.

Konkretisht është i nevojshëm që bazuar në sa më sipër të realizohen ndryshime, përditësime dhe shtesa në dokumentin “Instrumenti Lehtësues për Projektet e Infrastrukturës (IPF) Asistenca Teknike 4 (IPF4) WB11-ALB-ENE-01 Master Plani i Infrastrukturës së Gazit, Raporti Përfundimtar”, pjesë e Vendimit nr. 87, datë 14.2.2018 “Për miratimin e Planit të Zhvillimit të Sektorit të gazit natyror në Shqipëri (Master Planit të Gazit Natyror për Shqipërinë) dhe Identifikimin e Projekteve Prioritare në Fushën e Gazit Natyror”, sipas propozimeve të përmendura në pikën VI të këtij Relacioni.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

¹ Faqe 66, Instrumenti Lehtësues për Projektet e Infrastrukturës (IPF) Asistenca teknike 4 (IPF4) – EB11-ALB-ENE-01, Master Plani i Infrastrukturës së Gazit, Raporti Përfundimtar.

² Faqe 31, po aty

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 87, datë 14.2.2018 për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”.

Projektvendimi i propozuar është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në përputhje dhe zbatim të dispozitave 1, 2, 4 5, 10, 11 të Ligjit Nr.102/2015, datë 23.09.2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

Nëpërmjet këtij projektvendimi konkretizohet vizioni i Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe i Qeverisë Shqiptare në zhvillimin e një sektori të rëndësishëm të fushës së energjisë, i cili ndikon edhe në zhvillimin social dhe ekonomik.

Zhvillimi i sektorit të gazit natyror në Shqipëri është inkuadruar në kontekstin e Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë, traktat në të cilin Shqipëria është palë kontraktuese që në krijimin e tij në vitin 2055 dhe ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr.9501, datë 3.4.2006 “Për ratifikimin e Traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë”

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Ky projektvendim nuk përfron akte të Bashkimit Evropian. Gjithsesi, Master Plan i Gazit Natyror për Shqipërinë është konceptuar dhe realizuar në përputhje dhe në zbatim të Direktivave të Bashkimit Evropian që përbëjnë Paketën e Tretë të Energjisë dhe që janë përfshirë në ligjin nr. 102/2015, datë 23.12.2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Me anë të këtij projektvendimi propozohet disa shtesa dhe ndryshime, përshtatje dhe saktësime në përmbajtjen e disa neneve si më poshtë:

1. Pas pikës 1 të Vendimit Nr. 87, datë 14.02.2018, shtohet pika 1/1 me përmbajtje si më poshtë:
1/1. Ndërtimi dhe përdorimi i tubacioneve për transmetimin e shpërndarjen e gazit natyror, instalimeve të GNL-së, depozitave të gazit natyror, linjave direkte, lidhjes së sistemit shqiptar të gazit natyror me sistemet fqinje, si edhe çdo impianti, pajisjeje ose instalimi tjetër që përfshihet në sektorin e gazit natyror edhe nëse nuk janë parashikuar në Masterplan apo janë parashikuar me standarte të ndryshme, miratohen sipas parashikimeve të nenit 11 të Ligjit Nr. 102/2015 ‘Për sektorin e Gazit Natyror’.

- Në pikën 5.6 të dokumentit “Instrumenti Lehtësues për Projektet e Infrastrukturës (IPF) Asistenca Teknike 4 (IPF4) – WB-ALB-ENE-01 Master Plan i Infrastrukturës së Gazit, Raporti Përfundimtar të bëhet përditësimi duke bërë ndryshimet si më poshtë:

- **Ishte** “Presioni Maksimal i Lejuar:
 - 82 bar, për seksionet e IAP dhe 50 bar për pjesën tjetër të sistemit të transmetimit në Shqipëri
 - 50 bar, për sistemin e transmetimit në Shqipëri kur IAP nuk ekziston”
- **Bëhet:** Presioni Maksimal i Lejuar:
 - 82 bar, për seksionet e IAP dhe deri në 100 bar për pjesën tjetër të sistemit të transmetimit në Shqipëri

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 87, datë 14.2.2018 për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”.

- Deri në 100 bar, për sistemin e transmetimit në Shqipëri kur IAP nuk ekziston”
- Në pikën 3.2, paragrafi i dytë faqe 23, të dokumentit “Instrumenti lehtësues për Projektet e Infrastrukturës (IPF) Asistenca Teknike 4 (IPF4) – WB11-ALB-ENE-01 Master Plani i Infrastrukturës së Gazit, Raporti Përfundimtar”, të përditësohet përmbajtja me dokumentin në gjuhën Angleze, duke ndryshuar si më poshtë:
 - **Ishte:** Shoqëria TAP AG do të ndërtojë, dhe operojë gazsjellësin TAP. Shqipëria, Greqia dhe Italia kanë nënshkruar një marrëveshje ndërqeveritare për TAP-in. Në bazë të Vendimit të Përbashkët të Enteve Rregullatore të Energjisë të Italisë, Shqipërisë, dhe Greqisë në qershor 2013, TAP AG do të ofrojë të paktën një pikë dalje në Shqipëri (që gjendet në Fier), me një kapacitet prej 2-10mmk/ditë (0.73-3.65bmk/vit). Përveç Fierit, një pikë e dytë dalje është në diskutim në zonën e Kuçovës. Në bazë të marrëveshjes, TAP AG ka për të ndërtuar një pikë dalje në Shqipëri me një kapacitet minimal prej 0.3bmk/vit.
 - **Bëhet:** Shoqëria TAP AG do të ndërtojë, dhe operojë gazsjellësin TAP. Shqipëria, Greqia dhe Italia kanë nënshkruar një marrëveshje ndërqeveritare për TAP-in. Në bazë të Vendimit të Përbashkët të Enteve Rregullatore të Energjisë të Italisë, Shqipërisë, dhe Greqisë në qershor 2013, TAP AG është i detyruar të ndërtojë të paktën një pikë dalje me dydrejtime (bidireksionale), në Shqipëri (që gjendet në Fier), me një kapacitet prej 2-10mmk/ditë (0.73-3.65 bmk/vit). Përveç Fierit, një pikë e dytë dalje është në diskutim me zonën e Kuçovës.
- Në pikën 9 të dokumentit “Instrumenti Lehtësues për Projektet e Infrastrukturës (IPF) Asistenca Teknike 4 (IPF4) - WB11-ALB-ENE-01 Master Plani i Infrastrukturës së Gazit, Raporti Përfundimtar”, në listën e prioriteteve në Terma afatshkurtër, të shtohet pika 2/1 si më poshtë:
 - “2/1. Zhvillimi i pikës së daljes dhe rrjetit të shpërndarjes Bashkia Korçë”
 - në listën e prioriteteve në Terma afatmesëm, të shtohet pika 4/1 si më poshtë:
 - “4/1. Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së gazit të lëngshëm natyror.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e projekt aktit ngarkohen Ministria e Infrastruktues dhe Energjisë, ministritë dhe institucionet përgjegjëse të përmendura në dokumentet e paketës së Master Planit të Gazit përfshirë edhe shoqërinë Albpetrol sh.a., ALBGAS sh.a., TAP AG, etj.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi për ndryshimin e VKM nr. 87, datë 14.02.2023 është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria Albgaz sh.a.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 87, datë 14.2.2018 për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”.

Zbatimi i projektvendimit nuk shoqërohet me impakte financiare për buxhetin e shtetit.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE
MINISTËR**

BELINDA BALLUKU

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 87, datë 14.2.2018 për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare".